




REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. Dep.	2-D/DPK
Nr. llaq Broj stranica Nr. pages	02
Nr. Prot. Br. Prot. Prot No.	01-4093/15
Data Datum Date	13.11.2015
PRISHTINË	



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 12.11.2015, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-02-3925/14, për **z. Lekë Prenaj, Gjyqtar në Gjykatën Themelore të Prishtinës**, për shkak se nuk ka të dhëna të mjaftueshme që argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

Rasti i hapur nën dyshimin për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funksionit Publik për zyrtarin e lartë, z. Lekë Prenaj, Gjyqtar në Gjykatën Themelore të Prishtinës, dhe njëkohësisht person i autorizuar në Ndërmarrjen Publike Kompania e Ujësjetës Rajonal "Hidrodrini Sha. A" - Pejë, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Zyrtari i lartë, fillimisht është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit. Pas pranimit të kësaj shkrese, kemi organizuar një takim me zyrtarin e lartë, për të diskutuar për gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit.

Në takim zyrtari i lartë është njoftuar se gjatë ushtrimit të funksionit publik si zyrtar i lartë nuk mund të ushtroj funksion menaxherial në Ndërmarrje Publike, kjo për faktin se Ligji nr. 04/L-051, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit e ndalon këtë.

Mirëpo, zyrtari i lartë z. Prenaj gjatë takimit në Agjenci ka deklaruar se nuk ushtron funksion menaxherial në Ndërmarrjen Publike Kompania e Ujësjetllësit Rajonal "Hidrodrini Sha. A – Pejë", që nga data 30.11.2007.

Ndërkohë, Agjencia kundër Korrupsionit, zyrtarisht ka kërkuar nga Kryeshefi Ekzekutiv i Ndërmarrjes Publike Kompania e Ujësjetllësit Rajonal "Hidrodrini Sha A – Pejë", për të vërtetuar statusin e z. Prenaj në këtë Ndërmarrje.

Pas kësaj, Agjencia ka pranuar një shkresë zyrtare të dërguar nga Kryeshefi Ekzekutiv (DPKI-03-02/3929/15), me të cilën vërtetohet se z. Lekë Prenaj nuk ushtron funksion menaxherial në Ndërmarrjen Publike Kompania e Ujësjetllësit Rajonal "Hidrodrini Sha. A – Pejë".

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Hasan Preteni
Drejtör i Agjencisë kundër Korrupsionit

